



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.207/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.SH. Kolegji “Aga Xhite” me seli në Ferizaj, rr. Fanoli nr.156, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.771/18, të datës 15.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, në Prishtinë. **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.771/18, i datës 15.06.2020, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.771/18, të datës 15.06.2020, është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.SH. Kolegji “Aga Xhite” me seli në Ferizaj, rr. Fanoli nr.156. Në pikën II të dispozitivit është anuluar pjesërisht vendimi me nr.359/2010 i datës 11.10.2010 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës. Në pikën III të dispozitivit është obliguar e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë që paditësit N.SH. Kolegji “Aga Xhite” me seli në Ferizaj, rr. Fanoli nr.156, t’ia pranoj TVSh-në e zbritshme në shumë prej 32,878.33€ (tridhjetë e dy mijë e tetë qind e shtatëdhjetë e tetë euro e tridhjetë e tre cent), për periudhën tatimore 02/2005 deri me 12/2006, si dhe t’ia pranoj shpenzimin e qirasë për Tatim në të Ardhura Individuale në vlerë prej 197,373.40€ (një qind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tre qind e shtatë dhjetë e tre euro e dyzet cent), për vitet 2005 dhe 2006 përkatësisht vlerën prej 98,686.70€ (nëntë dhjetë e tetë mijë e gjashtë qind e tetëdhjetë e gjashtë euro e shtatë dhjetë cent) për secilin vit. Në pikën IV refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit N.SH. Kolegji “Aga Xhite” me seli në Ferizaj, rr. Fanoli nr.156, mbi shumat e aprovuara dhe at

për njohjen tri faturave furnizuese në vlerë të përgjithshme prej 56,070.30€ (28,600+14,530.00+940.00=56,070.30) të lëshuara nga subjekti NT “Petrol Nol”. Në pikën V mbetet në fuqi pjesa tjetër e vendimit nr.359/2010 i datës 11.10.2010 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Në pikën VI secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij vendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, propozon që të aprovohet ankesa e të paditurës ATK, si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues i ATK-së çështja të kthehet në Gjykatën e Shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së dytë. shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin, nr. 359/2010 i datës 11.10.2010, ka Aprovuar pjesërisht ankesën e tatimpaguesit N.SH. Kolegji “Aga Xhite” me seli në Ferizaj, rr. Fanoli nr.156 me NRF:600080436, drejtor S.B. nga Ferizaji, rr..... nr..... Ndryshohet vendimi i tatimit shtesë mbi Njoftim Rivlerësimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për periudhat tatimore: 02/2006; 04/2006 dhe Tatimin në të Ardhurat Individuale viti 2006 sipas njoftim rivlerësimeve të përpunuara nga Teknologjia Informative pas ankese. Ndërsa në pjesën tjetër vendimet mbi njoftim rivlerësimet e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatim në të Ardhurat Individuale mbeten të pa ndryshuara. Procedura e ankesës nuk ndërprehet sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas ligjit nr.2004/48 Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të palëve ndërgjyqëse, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar si në dispozitivin e lartcekur. Me arsyetim se: Gjykata konstaton se nga shkresat e lëndës, rezulton që e paditura ATK-Zyra Regjionale e Ferizajt me Raportin e

Kontrollit me nr.47 të datës 23.06.2010 duke vepruar sipas vendimit të ATK-së nr.33/2010 i datës 29.03.2010 ka kryer vlerësim tatimor (ri kontroll tatimore) për subjektin NSH Kolegji “Aga Xhite” këtu paditësin për periudhat dhe llojet e tatimeve, Tatim Mbi Vlerën e Shtuar TVSH prej vitit 02/2005-12/2006, Tatim të Mbajtur në Burim TMB dhe Kontribute Pensionale KP për periudhën 01/2005-12/2006 si dhe për Tatim në të Ardhur individuale për vitin 2005-2006. Me kontroll paditësi është ngarkuar me detyrimet tatimore shtesë në shumë të përgjithshme prej 68,846.90€ pa përfshirë ndëshkimet dhe interesin e kalkuluar sipas ligjit. Deri tek këto detyrime tatimore shtesë për paditësin ka ardhur si rezultat i mos njohës së TVSH së zbritshme dhe shpenzimeve të investimeve të ndodhura në objektin ndërtimor në pronësi të qiradhënësit B.A. si dhe nga mos njohja e TVSh-së së zbritshme nga subjektet e cilësuar si fiktive. Gjykata konstaton se e paditura me vendimin e kontestuar e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit dhe i ka ndryshuar njoftim rivlerësimet për tatim shtesë për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar për periudhat tatimore 02/2006, 04/2006 dhe njoftim rivlerësimet për tatim shtesë për Tatim në të Ardhura Individuale për vitin 2006 si rezultat i pranimit të blerjeve të mjeteve themelore nga faturat me nr.014701 dhe nr.014705 nga furnitori NTP “Labi Commerce” me NRB 70182552 me seli në Prizren. Për më tepër gjykata ka konstatuar se vet e paditura në vendimin e kontestuar i ka njohur dhe i ka pranuar paditësit dy faturat furnizuese të lëshuar nga subjekti NTP “Labi Commerce” dhe atë faturën me nr.014701 dhe faturën me nr.014705 siç u konstatua më lartë, gjegjësisht i ka pranuar si blerje të mjeteve themelore për TVSH dhe për shpenzimet e zhvlerësimet në pasqyrën financiare, por nuk i ka pranuar edhe fatura me nr.15941, nr.15942, nr.15944, nr.15945, nr.15946 të lëshuara nga subjekti “Val Trade” dhe fatura me nr. 14703 dhe nr.1407 të lëshuara nga subjekti i njëjti NTP “Labi Commerce” i cili i ka lëshuar fatura me nr.014701 dhe nr.014705. Nga ekzaminimi i faturave furnizuese të përmendura më lartë e të cilat e paditura nuk i ka njohur paditësit për efekte tatimore për TVSH të zbritshme dhe për Tatim në të Ardhura Individuale, gjykata konstaton se të gjitha këto fatura i plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara me nenin 14 të Rregullores nr.2001/17 për Ndryshimin e Rregullores nr.2001/11 për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar dhe nenin 12 të UA nr.01/2004 i datës 01.09.2004 për Zbatimin e Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar dhe se rregullsinë e këtyre faturave dhe shkresat e lëndës rezulton të mos ta ketë kontestuar as e paditura.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve*

ose të procesverbalit. Sipas nenit 199 te LPK-se parashihet se gjykata e çështjes ka për detyrë që menjëherë pasi t'i arrijë aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, të caktojë seancën përgatitore apo seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes e cila duhet të mbahet më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor pas arritjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, si dhe t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj.

Gjykata e Komerciale e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me veten më arsyetimin e tij. Në dispozitivin e aktgjykimit thuhet se Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit Nsh "Kolegji Aga Xhite" me seli në Ferizaj si e bazuar. Nën pikën II. II të dispozitivit është anuluar pjesërisht vendimi me nr.359/2010 i datës 11.10.2010 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës. Në pikën III të dispozitivit është obliguar e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë që paditësit N.SH. Kolegji "Aga Xhite" me seli në Ferizaj, rr. Fanoli nr.156, t'ia pranoj TVSh-në e zbritshme në shumë prej 32,878.33€ (tridhjetë e dy mijë e tetë qind e shtatëdhjetë e tetë euro e tridhjetë e tre cent), për periudhën tatimore 02/2005 deri me 12/2006, si dhe t'ia pranoj shpenzimin e qirasë për Tatim në të Ardhura Individuale në vlerë prej 197,373.40€ (një qind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tre qind e shtatë dhjetë e tre euro e dyzet cent), për vitet 2005 dhe 2006 përkatësisht vlerën prej 98,686.70€ (nëntë dhjetë e tetë mijë e gjashtë qind e tetëdhjetë e gjashtë euro e shtatë dhjetë cent) për secilin vit. Në pikën IV refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiisë së paditësit N.SH. Kolegji "Aga Xhite" me seli në Ferizaj, rr. Fanoli nr.156, mbi shumat e aprovuara dhe at për njohjen tri faturave furnizuese në vlerë të përgjithshme prej 56,070.30€ (28,600+14,530.00+940.00=56,070.30) të lëshuara nga subjekti NT "Petrol Nol". Në pikën V mbetet në fuqi pjesa tjetër e vendimit nr.359/2010 i datës 11.10.2010 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Në pikën VI secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale. Formulimi i tillë i dispozitivit të aktvendimit, këtë aktgjykim e bënë te paqarte dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, nga aktvendimi i kontestuar nuk është e qarte se gjykata e shkallës së parë, se cilën pjesë të kërkesëpadiisë e ka aprovuar dhe cilën pjesë të vendimit kontestues e ka anuluar. Nga ky formulim i tillë te jepe te kuptohet se sikur padia te jete aprovuar ne tersi, mirepo ne permbajtjen e tij nuk kuptohet asgje lidhur me aprovimin pjesërisht te padisë ne favor te subjektit ne procedure.

Kolegji i kësaj gjykate gjen se në rastin kur gjykata e shkallës së parë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të organit administrativ, kur aprovon pjesërisht padinë duke përshkruar pjesën e padisë të cilën e aprovon, ndërsa kur vendos në merita e ndryshon pjesërisht vendimin kontestues po ashtu duke përshkruar pjesën e ndryshuar të aktvendimit të kontestuar, dhe e obligon të paditurën ashtu siç ka vepruar në rastin konkret gjykata e shkallës së parë. Nga arsyet e cekura dhoma e shkallës e dyte gjeti se, gjykata e shkallës e parë ka bere shkeljen e dispozitave te sipercekura, te cilat ne riprocedure duhet te eliminohen ne atë mënyrë qe te merren parasysh sugjerimet e gjykatës shkallës dyte te dhëna me

aktvendimin, AA.325/2013. 14.03.2018, si dhe te vlerësoj te gjitha faktet vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve te palëve dhe pastaj të nxjerr një vendim te ligjshëm dhe te drejte.

Gjykata vlerëson se arsyetimi i vendimit kontestues është i mangët dhe nuk i ka elaboruar çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë konflikt administrative. Në rastin konkret nga dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar gjykata e shkallës së parë ka aprovuar pjesërisht padinë e paditësit, mirëpo nuk ka specifikuar cilën pjesë e ka aprovuar pjesërisht, cila pjesë e vendimit të kontestuar është anuluar dhe cila pjesë e tij ka mbetur në fuqi, andaj kolegji i kësaj gjykate konsideron se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe pa ndonjë bazë ligjore e cila e bën të qëndrueshme këtë vendimmarrje, nga çka rezulton se gjykata e shkallës së parë ka bere shkelje te dispozitës se nenit 160.3.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore ka gjetur se ankesa është e bazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetvete si dhe ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetim të aktvendimit nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Aktgjykimin e atakuar është përfshire në shkelje te dispozitave ligjit te procedurës kontestimore ne baze te nenit 183 te LPK-se pasi nuk është vërtetuar ne mënyre te plot gjendjen faktike. Andaj pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ti përkrähë si të rregullta dhe të ligjshme kolegji i kësaj gjykate për arsye se, arsyet në të cilat bazohen për faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes, janë jo të qëndrueshme dhe në kundërshtim me faktet të cilat i thekson në ankesë.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka aprovuar si te bazuar padinë e paditësit, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa vërtetuar me prova faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktgjykimi i atakuar nuk është e qarte se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi si ne dispozitiv te aktgjykimit te atakuar. Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar, doemos është dashur të prishet. Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm. Gjykata e shkallës së parë, ne ri procedurë duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i çartë dhe i kuptueshëm, të vendos për të gjitha kërkesat e palëve në procedurë, ti vlerësoj të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe në fund të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Për arsyet e lartë cekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i mënjanuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, e që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë, duhet ti mënjanoj të metat e cekura me lartë, duke vepruar sipas rregullave procedurale kontestimore, ti vërtetoj faktet relevante dhe provat që lidhen me pretendimet e paraqitura në ankesë, të vlerësoj dhe analizoj të gjitha provat e nevojshme konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që janë me rëndësi për vendosjen e rastit konkret. Ashtu që do të shqyrtohen dhe vërtetohen të gjitha faktet relevante dhe rrethanat që janë me ndikim për zgjidhjen e kontestit, dhe nëse është e nevojshme për te vërtetuar drejte dhe në mënyre të plot gjendjen faktike, të nxjerrët prova përmes ekspertizës përkatëse. Andaj, Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë duhet t'i ftoj palët dhe të hap shqyrtimin kryesor, të bëjë administrimin dhe vlerësimin e të gjithave provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, ato që gjenden në shkresat e lëndës apo prova të tjera eventuale që do të paraqiteshin nga palët, dhe më pas në mënyrë të drejtë të zbatoj të drejtën materiale, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, të sjell një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, dhe një dispozitiv të qartë, të kuptueshëm dhe të përmbarueshëm, dhe të arsyetuar mirë, të ndërtoj dispozitivin në atë mënyrë që i njëjti të jetë i kuptueshëm, i qartë dhe i ekzekutueshëm, për palët dhe për gjykatën.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, si dhe nenit 195 par.1 pika c), të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.207/22 me datë 26.07.2023

**Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi**